



Republika e Kosovës – Republika Kosova
Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresa
Izborni Panel za Žalbe i Predstavke

Anr.09/2017

Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresa (PZAP), i përbërë nga gjyqtarët: Dr.sc. Rafet Haxhaj kryesues, Fejzullah Rexhepi dhe Adnan Konushevi anëtarë, duke vendosur lidhur me apelin e subjektit politik Partia Liberale e Kosovës (PLK), të paraqitur kundër vendimit të Komisionit Qendror të Zgjedhjeve (KQZ) me nr. protokolli 102/2017, të datës 07.02.2017, për shkak të pezullimit të subjektit politik nga Regjistri i Partive Politike të Regjistruara në Komisionin Qendror të Zgjedhjeve (KQZ), në seancën e panelit të mbajtur me 13.02.2017, mori këtë:

V E N D I M

REFUZOHET si i pabazuar apeli i subjektit politik Partia Liberale e Kosovës (PLK), i paraqitur kundër vendimit të Komisionit Qendror të Zgjedhjeve (KQZ) të datës 07.02.2017, me Nr.Prot.102/2017.

A r s y e t i m

Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresa - PZAP, me datë 09.02.2017 ka pranuar një apel nga subjekti politik PLK, të paraqitur kundër vendimit të KQZ-së, me numër protokolli 102-2017 të datës 07.02.2017, me të cilën pretendon se përmes postës elektronike është njoftuar nga KQZ, me vendim lidhur me pezullimin e këtij subjekti politik, nga Regjistri i Partive Politike të Regjistruara në KQZ. Parashtruesi i apelit me tutje thekson se, në mungese të zyrës për ushtrimin e veprimtarisë, nuk ka marrë njoftime paraprake, dhe njoftime te rregullta lidhur me pezullimin e këtij subjekti politik. Parashtruesi i apelit, kërkon nga PZAP që të anulohet vendimi e KQZ-së, lidhur me pezullimin e subjektit politik PLK.

PZAP-i, në kuptim të nenit 6 par 6 të Rregullave dhe Procedurave të PZAP-it, e informoi KQZ-në, për apelin që është bërë ndaj vendimit të saj. Në përgjigjen e ofruar nga KQZ, theksohet se Partia Politike e regjistruar "Partia Liberale e Kosovës" me akronim PLK, me vendim të Komisionit Qendror të Zgjedhjeve, me datë 07.02.2017, është pezulluar nga Regjistri i Partive Politike të Regjistruara, për arsye të mos dorëzimit të dhënave të ndryshuara vjetore, deri me 31 Janar të çdo viti sipas nenit 11.1 të Rregullës Nr.01/2013 për Regjistrimin dhe Veprimin e Partive Politike, si dhe në vendimin për pezullim, PLK obligohet që në afat shtesë të shtuar prej njëzet (20) ditësh nga dita e pezullimit të kryej detyrimet e saj sipas nenit 6 (cc) të Rregullës së lartcekur.

Gjithashtu në përgjigje theksohet se Zyra me datë 07.02.2017 për vendimin e KQZ-së, ka njoftuar përfaqësuesin e subjektit politik z. Skender Gashi, ndërsa Kryetarit të subjektit politik z. Gjergj Dedaj, i ka dërguar vendimin me postë elektronike me datë 08.02.2017.

KQZ, në përgjigjen e saj si dëshmi ka bashkangjitur:

- Vendimin e KQZ-së,
- Njoftimin elektronik lidhur me vendimin e KQZ-së.

PZAP-i, pas administrimit të pretendimeve ankimore, vendimit kontestues të datës 07.02.2017 me numër protokolli 102/2017 të KQZ-së dhe përgjigjes në apel të KQZ-ZRPPC-së gjeti se:

Apeli është i pabazuar.

PZAP, konstaton se KQZ-ja me vendimin me Nr.102/2017 të datës 07.02.2017, ka vendosur drejt kur ka bërë pezullimin nga Regjistri i Partive politike për subjektin politik PLK.

Dispozita e nenit 11.1 të Rregullës Zgjedhore Nr.01/2013 për Regjistrimin dhe Veprimin e Partive Politike ka përcaktuar që *“Partia e regjistruar politike i kompletton dhe ia dorëzon Zyrës të dhënat e ndryshuara vjetore deri më 31 janar të çdo viti duke identifikuar të dhënat e ndryshuara vjetore”*.


Siç vërtetohet edhe nga shkresat e lëndës, subjekti politik Partia Liberale e Kosovës-PLK, nuk i ka përmbushur obligimet ligjore të cilat parashihen me nenin 11.1 të Rregullës Zgjedhore Nr.01/2013, andaj PZAP-i vlerëson se, KQZ-ja ka vepruar në pajtim me dispozitat ligjore të Rregullës Zgjedhore Nr.01/2013, neni 6 paragrafi 1 pika (cc) kur ka obliguar subjektin politik PLK, që në afat të shtuar prej njëzet (20) ditësh nga dita e pezullimit të kryej detyrimet e saj sipas nenit 11 të kësaj Rregulle Zgjedhore.

Bazuar në këto që u theksuan PZAP konstaton se vendimi me Nr.102-2017 i datës 07.02.2017 i KQZ-së, është i drejtë dhe i bazuar në ligj, ndërsa pretendimet e parashtruara në apel janë të pabazuara.

Për arsyet e cekura si më lartë e në pajtim me nenin 115.1 lidhur më nenin 118.1 të LZP-së, është vendosur si në dispozitiv të këtij vendimi.

Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtrës
Anr. 09/2017 më datën 13.02.2017

Kryesuesi i Panelit
Dr.sc. Rafet Haxhaj



Këshillë juridike: *Kundër këtij vendimi pala e pakënaqur, mund të paraqet ankesë brenda afatit prej njëzet e katër (24) orëve nga momenti i marrjes-pranimit të këtij vendimi në Gjykatën Supreme të Kosovës.*